

VENDIM
Nr. 994, datë 9.12.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 422, DATË 6.5.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E
FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR
DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT, PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE
TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe në vijim të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të kreut I, të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

- Znj. Fjoralba Caka zëvendësohet me znj. Adea Pirdeni;
- Znj. Belinda Ikonomi zëvendësohet me z. Besart Kadia.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe